



Republika e Kosovës Republika Kosovo • Republic of Kosovo	
Instituioni i Avokatit të Popullit Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution	
Nr./Br./No.	54112019
Nr.i fq/Bр.str./Nr.pg.	
Data/Datum/Date:	03/04/19
PRISHTINË-PRIŠTINA-PRISTINA	



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Instituioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Rasti A. nr. 288/2018

në lidhje me

me mos aprovimin e kërkesës për kthim në listat prioritare, si dhe efektin juridik të anulimit të vendimit nr. 2/988 të datës 26 nëntor 2013, të Senatit të UP- së

Drejtuar:

- Z. Marjan Dema, Rektor i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”

Prishtinë, 3 prill 2019

PËRMBAJTJA

QËLLIMET E RAPORTIT	2
BAZA LIGJORE	2
PËRSHKRIMI I RASTIT	3
SFONDI LIGJOR	4
ANALIZA JURIDIKE DHE KONSTATIMET E AVOKATIT TË POPULLIT	4
REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT	6

QËLLIMET E RAPORTIT

1. Qëllimi i këtij raporti është njoftimi i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” (në tekstin e mëtejmë UP), lidhur me shkeljen e të drejtës për arsim, në rastin e mos aprovimit të kërkesës së disa studentëve për kthimin në listat prioritare, pas anulimit të vendimit nr. 2/988 të datës 26 nëntor 2013, i nxjerrë nga Senati i UP.
2. Të shpjegoj efektin juridik të anulimit të vendimit nr. 2/988 (*theks i shtuar*), të datës 26 nëntor 2013, i nxjerrë nga Senati i UP-së.
3. Po ashtu, qëllimi i këtij raporti është për t'u dërguar institucioneve kompetente rekomandime specifike dhe konkrete që nëpërmjet legjisacionit, të specifikojë afate për kohëzgjatjen e një procedure gjyqësore.

BAZA LIGJORE

4. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nen 132, paragrafi 1, përcakton se: “Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike”.
5. Neni 135, paragrafi 3, përcakton se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”.
6. Sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - “Avokati i Popullit ka kompetencë për t'i hetuar ankesat e pranuara nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.” (neni 16, par. 1);
 - “të térheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tillë dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tillë (neni 18, par. 1, nënpar. 2);
 - “të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (neni 18, par 1, nënpar 5);
 - “t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, par. 1, nënpar. 6);
7. Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij në media, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi ligjore.

PËRSHKRIMI I RASTIT

8. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi, të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka pranuar ankesë nga znj. Festime Mehdiu (dhe të tjeterët), ndaj UP-së, lidhur me mos aprovimin e kërkesës për rikthim në listat prioritare, në studimet e doktoratës.
9. Nga rrethanat e rastit, Avokati i Popullit ka vërejtur se Universiteti i Prishtinës, më 25 shtator 2013, ka shpallur konkurs për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës. Më tej, më 6 nëntor 2013, UP ka publikuar listat prioritare të kandidatëve që janë pranuar në studimet e doktoratës, në të cilat figurajnë edhe emrat e ankueseve, si studente të pranuara.
10. Pas publikimit të listave prioritare të cilat pasqyronin emrat e studentëve të suksesshëm në këtë konkurs, më 26 nëntor 2013, Senati i UP-së nxjerr Vendim Nr. 2/988, me të cilin vendos kritere shtesë për pranim dhe në këtë mënyrë largohen nga listat prioritare një numër studentësh. Lidhur me këtë çështje, disa prej studentëve të larguar kishin paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë GjThP), duke shfaqur pretendimet e tyre se vendimi në fjalë është i kundërligjshëm dhe si i tillë duhet të anulohet.
11. Më 28 prill 2015, GjThP ka nxjerr Aktgjykim C.nr. 442/14 me të cilin i ka njojur të drejtën paditësve duke e anuluar vendimin nr. 2/988 të nxjerrë nga Senati i UP-së. Për më tepër Gjykata e Apelit (në tekstin e mëtejmë GjA), me Aktgjykimin AA.nr. 243/2017, i datës 10 tetor 2017, ka vërtetuar aktgjykimin e GjThP si të bazuar.
12. Më tej, Senati i UP-së më 22 mars 2018, ka nxjerrë vendim nr. 776 me të cilin ka zbatuar aktgjykimin C. nr.442/14 të GjThP, dhe Aktgjykimin AA.nr. 243/2017 të GjA, duke i pranuar paditësit të cilëve gjykata ju ka dhënë të drejtë.
13. Duke pasur parasysh faktin se gjykata ka anuluar Vendimin nr. 2/988, znj. Festime Mehdiu, znj. Naime Beqiraj, znj. Vaide Kqiku – Hoxha, znj. Valentina Sopjani, znj. Jehona Shala dhe znj. Shkurta Çitaku, më 28 mars 2018, kanë kërkuar nga Senati i UP-së kthimin në listat prioritare.
14. Lidhur me kërkesën e paraqitur nga ankueset, Senati i UP-së nuk kishte kthyer përgjigje në afatin e përcaktuar ligjor dhe për këtë arsyet e ankueset i janë drejtuar me ankesë Avokatit të Popullit.
15. Pas komunikimeve të realizuara, Avokati i Popullit është informuar nga UP se ankueset nuk kanë qenë pjesë e padisë dhe në këtë mënyrë atyre nuk ju takon e drejta për kthim në listat prioritare edhe përkundër faktit që gjykata ka anuluar vendimin e UP-së.
16. Më tej, më 16 tetor 2018, Senati UP-së ka nxjerr Vendim nr. prot. 3/141 me të cilin ka refuzuar kërkesën e znj. Mehdiu dhe të tjera me arsyetimin e njëjtë se nuk kanë qenë pjesë e padisë, sipas të cilës është anuluar vendimi 2/988.

SFONDI LIGJOR

17. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nen 3, paragrafi 2, përcakton se “*Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të tē gjithë individëve . . .*“
18. Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative,
 - Neni 6, paragrafi 2, përcakton se: ”*Personat në tē njëjtën situatë trajtohen në mënyrë tē njëjtë*“;
 - Neni 8 [Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe tē arsyeshme], përcakton:
“*1. Veprimet e organeve publike duhet tē jenë tē parashikueshme dhe tē respektojnë pritshmëritë legitime dhe tē arsyeshme tē personave.*
2. Një veprim administrativ nuk mund tē ndryshojë në mënyrë tē pajustifikuar nga një praktikë administrative e mëparshme e tē njëjtit organ pér raste tē njëta a tē ngashme”;
 - Neni 53 [Procedura dhe efektet e anulimit dhe shfuqizimit], paragrafi 2, përcakton se: ”*Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në tē kaluarën (retroaktive) . . .*“.

ANALIZA JURIDIKE DHE KONSTATIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

19. Avokati i Popullit thekson se parimi i barazisë është parim bazë i rendit shtetëror – juridik, themeli në tē cilin bazohet dhe ndërtohet rendi shtetëror – juridik, si dhe e drejtë themelore e qytetarëve e garantuar me Kushtetutë. Është e rëndësishme tē thuhet se, pér shkak tē faktit se tē gjithë qytetarët kanë dinjitet tē barabartë shoqëror, çfarëdo dallimi i palejueshëm në mes njerëzve ose grupeve paraqet arbitraritetin e pushtetit¹, dhe e cenon barazinë para ligjit.
20. Në këtë drejtim, barazia e qytetarëve manifestohet si barazia para ligjit dhe barazia para gjykatës. Lidhur me këtë, vendimet e organeve administrative ndikojnë në një masë tē madhe në realizimin e tē drejtave tē qytetarëve tē parapara me ligj. Krahas kësaj, përmes tyre sendërtohen normat e përgjithshme në një fushë tē gjerë tē veprimtarisë administrative, prandaj, si nga pikëpamja e tē drejtave tē njeriut, ashtu edhe nga aspekti i sundimit tē ligjit, është me rëndësi që vendimet e organeve administrative tē jenë tē ligjshme dhe në pajtim me standardet pér tē drejtat e njeriut. Parashikueshmëria e vendimeve administrative, krahas aspektit tē ligjshmërisë dhe tē drejtave tē njeriut, përmban në vete edhe garantimin e një sigurie juridike, e cila është një komponentë e rëndësishme e realizimit tē parimit tē sundimit tē së drejtës. Zbatimi unik i së drejtës, pra edhe tē së drejtës administrative pa dyshim se është qëllim drejtë tē cilit duhet synuar çdo sistem juridik i bazuar në sundimin e ligjit

¹ Enver Hasani & Ivan Čukalović, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi 1, Prishtinë 2013, faqe 21 – 22.

21. Në bazë të rrethanave të përcaktuara më sipër, Avokati i Popullit thekson vë në pah që sipas përcaktimeve kushtetuese, secili individ në Republikën e Kosovës trajtohet në bazë të parimit të barazisë para ligjit (neni 3, paragrafi 2).
22. Në po të njëjtën fryshtë juridike, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton të drejtën e secilit person që në situata të njëjta të trajtohen në mënyrë të njëjtë.
23. Avokati i Popullit konsideron se, nxjerra e vendimit nr. 2/988 ka dërguar në cenimin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme të kandidatëve të cilët kanë qenë pjesë e listave prioritare të publikuara nga UP-ja.
24. Avokati i Popullit konsideron se publikimi i listave prioritare me kandidatët e suksesshëm shpie tek pritshmëria e ligjshme dhe e arsyeshme e këtyre kandidatëve, për faktin se atyre ju është njojur një e drejtë.
25. Koncepti i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme në mbrojtjen e të drejtave subjektive është një koncept gjithëpërfshirës interpretimi në praktikën gjyqësore ndërkombëtare. Sipas GJEDNJ-së (shih rastet *Kopecky v. Slovakia*, *Aktgjyrimi i datës 28 shtator 2004, § 45-52; Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.), nr. 39794/98, § 73, GJEDNJ 2002-VII*), “pritshmëria legitime” duhet të jetë e një natyre konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore dhe në akte ligjore. Në rastin aktual, pritja legitime e kandidatëve të përzgjedhur bazohet publikimin e listave prioritare, sipas të cilave janë listuar kandidatët e pranuar për studime të doktoratës.
26. Më tej, Avokati i Popullit vëren se disa nga kandidatët që ishin në listat prioritare, të pakënaqur me vendimin nr. 2/988, kishin paraqitur padi në GjThP, duke kërkuar anulimin e vendimit në fjalë dhe kthimin e tyre në listat prioritare. Në këtë drejtim, më 28 prill 2015, GjThP ka nxjerr Aktgjykim C.nr. 442/14 me të cilin i ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve dhe ka anuluar vendimin nr. 2/988 të nxjerrë nga Senati i UP-së. Po ashtu, GjA më 10 tetor 2017, ka nxjerrë Aktgjykimin AA.nr. 243/2017, duke e vërtetuar aktgjykimin e GjThP si të bazuar.
27. Përkitazi me këtë çështje, Senati i UP-së, më 22 mars 2018, ka nxjerrë vendim nr. 776 me të cilin ka zbatuar aktgjykimin C. nr. 442/14 të GjThP, dhe Aktgjykimin AA.nr 243/2017 të GjA, por vetëm për paditësit emrat e të cilëve përmenden në aktgjykim, por jo edhe për kandidatët e tjerë, në situatë dhe rrethana të njëjta, të cilët ishin afektuar nga vendimi i kundërligjshëm i Senatit.
28. Më tej, Avokati i Popullit vëren se znj. Mehdiu dhe të tjerët, më 28 mars 2018, kanë kërkuar nga Senati i UP-së kthimin në listat prioritare, pas anulimit të Vendimit 2/988 nga gjykata.
29. Lidhur me këtë çështje, Senati i UP-së nuk ka kthyer përgjigje në afatin e përcaktuar ligjor, mirëpo pas komunikimeve ndërmjet përfaqësuesve të IAP dhe përfaqësuesve të UP, Senati i UP në mbledhjen e mbajtur më 5 tetor 2018, ka nxjerr vendim sipas të cilit e ka refuzuar kërkesën e znj. Mehdiu dhe të tjerët për rikthim në listat prioritare me arsyetimin se emrat e tyre nuk kanë qenë pjesë të aktgjykit të GjThP dhe GjA.

30. Avokati i Popullit tërheqë vëmendjen se me anulimin e vendimit nr. 2/988 nga GjThP dhe GjA, kanë pushuar së ekzistuari pengesat juridike sipas të cilave studentët janë lënë jashtë listave prioritare.
31. Ky konstatim i Avokatit të Popullit bazohet në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 53, paragrafi 2 sipas të cilit anulimi i një akti administrativ ka efekt juridik edhe në të kaluarën (retroaktive).
32. Së këndejmi Avokati i Popullit vlerëson se refuzimi i kërkesës së znj. Mehdiu dhe të tjerët nga Senati i UP-së, për rikthim në listat prioritare, e ka cenuar të drejtën e e kandidatëve për të qenë të barabartë para ligjit.
33. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek një praktikë e ngjashme, sipas të cilës Inspektorati Policor i Kosovës (në tekstin e mëtejmë IPK), ka vepruar pas anulimit të vendimit nga gjykata. Lidhur me këtë rast Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, më 29 dhjetor 2017, kishte nxjerrë vendim me të cilin kishte anuluar procedurën e rekrutimit për pozitat Inspektor hetues, pasi që ishte shpall rezultati për kandidatët e suksesshëm. Më tej, lidhur me këtë çështje, 9 kandidatë kanë paraqitur padi në GjThP, e cila pas zhvillimit të procedurës ka lëshuar aktgjykimin C.nr 321/2018 duke aprovuar kërkesëpadinë paditësve dhe ka anuluar Vendimin e datës 29 dhjetor 2017, po ashtu edhe AP me aktgjykimin AC.nr 1546/2018 e ka vërtetuar aktgjykimin e GjThP. Pas plotfuqishmërisë së këtyre aktgjykimeve, IPK ka zbatuar obligimet e caktuara nga gjykata, duke i pranuar të gjithë inspektorët hetues (16) që kishin figuruar në listën e kandidatëve të suksesshëm, të cilët ishin afektuar me vendimin për anulim nga Kryeshefi i IPK-së.
34. Avokati i Popullit sugjeron që përshtatshmërisht me këtë të veproj edhe UP-ja, sepse në këtë rast vetëm 9 kandidatë kanë paraqitur padi, ndërsa nga anulimi i vendimit në fjalë kanë përfituar 16 kandidatët të cilët kanë qenë pjesë e listës me kandidatët e suksesshëm, pa marrë parasysh faktin nëse të gjithë kandidatët kishin paraqitur padi në gjykatë apo jo.
35. Përfundimisht, Avokati i Popullit konstaton se anulimi i një akti nga gjykata, ka efekt juridik ndaj të gjithë personave të cilët janë goditur nga ai akt.
36. Në bazë të vlerësimit të mësipërm, Avokati i Popullit konstaton se efekti i anulimit të vendimit 2/988 të Senatit të UP-së, duhet të reflektojë ndaj të gjithë kandidatëve që janë afektuar nga ai vendim.
37. Si rrjedhojë e kësaj, refuzimi i kërkesës për kthim në listat prioritare pas anulimit të vendimit nr. 2/988, përbën shkelje të barazisë para ligjit.

REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 18, paragrafi 1, nënparagrafi 5 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon :

Senatin e Universitetit të Prishtinës

- Që duke pasur parasysh faktin e anulimit të vendimit nr.2/988, me aktgjykimin C.nr. 442/14 të GjThP dhe aktgjykimin AA. nr. 243/2017 të GjA, të rishqyrtojë kërkesën për kthim në listat prioritare të znj. Festime Mehdiu, znj. Naime Beqiraj, znj. Vaide Kqiku – Hoxha, znj. Valentina Sopjani, znj. Jehona Shala dhe znj. Shkurtë Çitaku, si dhe t'u njihet e drejta për kthim në listat prioritare.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkua të pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.


Me nderime,
Hilmi Jashari
Avokat i Popullit